

NE EMER TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal, me Gjyqtarin Mustaf Tahiri, duke vendosur në lëndën penale ndaj të pandehurit A.P., Komuna Ferizaj, rruga “.....”, nr..... , për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës, duke vendosur lidhur me Aktakuzën e Prokurorisë Themelore ne Ferizaj, Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr. 1598-2/15 dt.23.06.2016 dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor të paraqitur në aktakuze, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datë 19.04.2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore ne Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 1598-2/15 dt.23.06.2016, dhe kjo Gjykate i jep këtë;

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari,

A.P., nga Ferizaj, rr. ”.....”, nr....., data e lindjes....., nga i ati H., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me dt. 29.08.2015, rreth orës 10:00, në rrugën rrugën ”Vëllezrit Gërvalla” në Ferizaj, duke drejtuar automjetin e markës “VW Golf”, me targa të regjistrimit, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 42/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia fillon të çkyqet nga rruga kryesore për tu kyçur në rrugën kryesore të cilin veprim e ndërmer pa u bindur se mund të rrezikoj pjesëmarrësit tjerë në komunikacion dhe me pjesën e përparme e godet biciklistin L.E.Q. i cili nga kjo goditje pëson lëndime të lehta trupore, lëndime të përshkruara në ekspertizën mjeko ligjore.

Me çka ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës.

Andaj gjykata ne baze te nenit 4, 7, 17, 41, 46, 73, te KPRK-se, dhe nenit 359, 360, 361, 365 dhe 495, te KPP-se i;

SHQIPTON

DENIMIN ME GJOBË në shumë prej 200€ (dyqind euro), të cilin dënim do ta paguaj 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veproj në bazë të nenit 46 të KPRK-se, në zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur 20 € për një ditë të kaluar me burg.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro, kurse për shpenzime të procedurës penale të paguaj shumën prej 30.66 € për ekspertizë të komunikacionit si dhe për ekspertizën mjeko-ligjore shumën 20.00 € , në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

I dëmtuari L.E.Q. nga Ferizaj rr.”.....” pn, për realizimin e kërkesës pasurore juridikë udhëzohet në kontestin civil juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr. 1598-2/15 dt.23.06.2016, se bashku me kërkesën për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor, kundër të akuzuarit, A.P. nga Ferizaj, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës.

Gjykata shqyrtoj Aktakuzën dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor dhe gjeti se Aktakuza dhe kërkesa janë të bazuar në bazë të nenit 495 të KPP-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-ës, që pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor të merr vendim për urdhër ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që nga shkresat e lëndës vërtetohet se ka prova të mjaftueshme, të cilat vërtetojnë fajësinë e të akuzuarit se ka kryer veprën penale e cila i vihen në barrë sipas aktakuzës së Prokurorisë.

Gjykata, vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë provat të cilat janë të mjaftueshme e për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit, se ka kryer veprën penale e për të cilën ngarkohet, sipas aktakuzës së prokurorisë, kjo vërtetohet nga provat si vijojnë: mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko ligjor i datës 20.04.2016, mendimi i ekspertit të komunikacionit i datës 12.02.2016 nga eksperti i komunikacionit rrugor ing.F.S., deklarata e të pandehurit e datës 29.08.2015, deklarata e të dëmtuarit L.E.Q. e dt.29.08.2015, raporti mjekësor i Spitalit në Ferizaj –Qendra Emergjente i dt.29.08.2015, me nr.540, raporti i aksidentit nr. 2015-CF-1735 si dhe në fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata konstaton se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet,

andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas KPRK-se, vepra penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-ës është vepër penale e dënueshme me gjobë apo burgim deri në një (1) vit,

I dëmtuari L.E.Q. nga Ferizaj rr.”.....” pn, për realizimin e kërkesës pasurore juridikë udhëzohen ne kontestin civile juridik.

Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPP-së, obligohet i pandehuri që në emër të shpenzime të procedurës

penale në emër të ekspertizës mjeko ligjore dhe ekspertizës së komunikacionit të paguaj shumën prej 50.66€ si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nga theksimet e theksuara si me lartë u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.579/16 dt.19.04.2017

Gjyqtari
Mustaf Tahiri

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi pala ka te drejtë kundërshtimi, ne afat prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit, kundërshtimi i parashtrohet kësaj gjykate.